

DEKLARATË PUBLIKE E ORGANIZATAVE TË GRAVE

Drejtuar:

- Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë - Kryetar i Partisë Socialiste
- Z. Niko Peleshi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
- Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë

Ne, organizatat e grave dhe të të drejtave të njeriut, shprehim shqetësimin e thellë për përpjekjet e vazhdueshme për të dobësuar **Projektligjin për Barazinë Gjinore**, i cili pasqyron **rreth tre dekada sakrifica, punë lobimi dhe advokimi të grave shqiptare** për barazi dhe drejtësi shoqërore.

Ky ligj:

- **forcon barazinë gjinore** në punë, arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe vendimmarrje;
- **adreson stereotipet gjinore**, promovon përdorimin e gjuhës me ndjeshmëri gjinore dhe kërkon vlerësim të ndikimit gjinor në çdo ligj;
- **mbron të drejtat e individëve**, duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me standardet e BE-së dhe rekomandimet e konventave ndërkombëtare;
- **nuk krijon gjini të reja**, nuk ndryshon jetën familjare dhe nuk imponon terminologji të detyrueshme mbi qytetarët.

Ne shprehim **shqetësimin e veçantë** për faktin se amendimet e propozuara nuk mund të jenë pjesë e një ligji që synon **barazi dhe respekt të të drejtave të njeriut**. Çdo ndryshim që minon këto parime **do të ishte një hap prapa për shoqërinë shqiptare**, pavarësisht sfidave dhe vështirësive globale.

Ne kërkojmë:

1. **Miratimin e ligjit në formën e plotë** të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në konsultim me të gjitha grupet e interes, **ku përfshihemi edhe ne**, pa ndryshime që çënojnë barazinë gjinore;
2. **Debat të hapur dhe transparent me pjesëmarrjen** e ekspertëve të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile;
3. **Mbështetjen publike të përkushtimit ndaj barazisë, dinjitetit dhe të drejtave të njeriut** si themel i integritetit evropian dhe demokracisë në Shqipëri.

Çdo pengesë apo dobësim i ligjit me kërkesë nga grupe të caktuara nuk duhet të na shenjojë si shoqëri dhe është një kërcënim për përparimin e mundimshëm 30-vjeçar të grave shqiptare.

Me respekt,

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Tiranë

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë

Agritra-Vizion, Peshkopi

Gruaja tek Gruaja, Shkodër

Qendra psiko-sociale "Vatra", Vlorë

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë

Forumi Gruas Elbasan, Elbasan

Shoqata "Jona", Sarandë

Shoqata "Unë Gruaja", Pogradec

YWCA Albania, Tiranë

Qendra për zhvillim Komunitar " Sot për të Ardhmen"

Qendren per Advokim Social

AWA (Gruaja Shqiptare në Audiovizual)

Shoqata e Grave "Refleksione"

Organizata Ura të Reja

Qendra A.L.T.R.I. (Albanian Legal and Territorial Institute Research)

Instituti për Kontraten Sociale

Insituti per Zhvillim dhe Inisiativa Qytetare

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nisma ARSIS

Qendra per Zhvillim dhe Integrim European (CEDI)

Fondacioni Së bashku

Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri"

Aleanca LGBT

Qendra Shkence dhe Inovacion per Zhvillim – SCiDEV

Shoqata "Bash – Art"